



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 1781 prot.

Shkodër, më 27.9. 2026

**VENDIM
Nr. 4, datë 26.01.2026**

**PËR MIRATIMIN E SHITJES SË MJETEVE TË TRANSPORTIT, ME PROCEDURË
ANKANDI PUBLIK, SI AUTOMJETE NË TËRËSI, SI DHE TË AUTOMJETEVE DHE
MATERIALEVE QË PËRMBAJNË HEKUR, ME PROCEDURË ANKANDI PUBLIK
PËR SKRAP**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 26.01.2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në ligjin nr. 139, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar; ligjin nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar; ligjin nr. 9874, datë 14.02.2008, "Për ankandin publik", i ndryshuar; Kreun IV të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar; si dhe në dokumentacionin e përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër,

VENDOSI:

1. Miratimin e shitjes së mjeteve të transportit, me procedurë ankandi publik, si automjete në tërësi, sipas të dhënave më poshtë:

Lista e mjeteve të transportit që do të shiten							
Automjeti	Viti i Prodhimit	Marka	Fuqia Motorrike	Pesha neto kg	Çmimi në Lek	Në pronësi	Vendndodhja
Makinë Teknologjike	1998	APV/Volvo	5480 cm ³	11,300 kg	1,000,000	Bashkia Shkodër	Bashkia Shkodër
Makinë Teknologjike	2001	ATV IVECO FIAT	5861 cm ³	8000 kg	850,000	Bashkia Shkodër	Bashkia Shkodër

Adresa: Rr. "13 Dhjetori", Nr.1, Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al

2. Miratimin e shitjes, me procedurë ankandi publik, për skrap, të automjeteve dhe materialeve që përmbajnë hekur, të cilat janë jashtë përdorimit, të amortizuara plotësisht dhe të panevojshme për funksionimin e Bashkisë, sipas tabelës së përlogaritjes së vlerës së hekurit, bazuar në çmimin e konfirmuar nga dogana dhe peshën totale të materialeve metalike, si më poshtë vijon:

Pesha	Çmimi USD/ton	Çmimi USD/kg	Koeficienti i vlerësimit	Kursi i këmbimit, i marrë nga Banka e Shqipërisë në ditën e hartimit të këtij relacioni	Vlera USD	Vlera në lekë
a	b	c	d	e	$f=a * c * d$	$G=f * e$
30668	314,83	0.31483	1	83.54	9,655.21	806,596.24

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

Miratuar me 23 vota

Vota Pro 23
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 9
Zbardhur me datë 27.01.2026

SEKRETARE

Sabina Danaj

KRYETAR

Oltion LULLI